



REPUBLIKA E KOSOVES/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIK OF KOSOVA
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

Këshilli Prokurorial i Kosovës duke u bazuar në nenin 4 pika 1.15 dhe nenin 15 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 18 tetor 2013 miratoi:

RREGULLORE NR. 04/2013

**PËR STRUKTURËN ORGANIZATIVE DHE FUNKSIONALE TË
NJËSITIT PËR SHQYRTIMIN E PËRFORMANCËS SË PROKURORIVE**

Neni 1 Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohet struktura organizative dhe funksionale e organizimit të Njësitit për Shqyrtimin e Përformances së Prokurorive (Njësi).

Neni 2 Mandati i Njësitit

1. Nën udhëheqjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës, Njësi raporton mbi punën e prokurorive.
2. Njësi ka përgjegjësi kryesore si në vijim:
 - a) Mbikëqyr dhe raporton mbi punën e prokurorive (përfshirë nevojat për trajnim);
 - b) Mbështet procesin e vlerësimit të performancës së prokurorëve individual dhe të prokurorive;
 - c) Mban shënimet statistikore dhe baza të dhënave sipas nevojës;
 - d) Përgatit raporte sipas kërkesë nga KPK-ja dhe/ose nëse ka nevojë;
 - e) Verifikimi prokurorial (mbështetja e procesit të emërimit të prokurorëve);
 - f) Kryen detyra tjera sipas udhëzimit të KPK-së.

Neni 3 Drejtori i Njësitit

1. Njësi udhëhiqet nga Drejtori i cili zgjidhet dhe emërohet nga Këshilli Prokurorial i Kosovës në pajtim me procedurat, kriteret dhe kualifikimet që do të zhvillohen dhe miratohen nga Këshilli përmes rregulloreve të cilat janë në përputhje me detyrimet kushtetuese dhe detyrimet e rregulloreve të zbatueshme për personelin.
2. Drejtori është përgjegjës ndaj Këshillit për administrimin efikas të Njësitit dhe i raporton drejtpërdrejtë Kryesuesit të Këshillit dhe iu përgjigjet të gjitha kërkesave të këshillit për informata.
3. Drejtori në çdo fund vit do të paraqes planin vjetor të punës në Këshill.

Neni 4

Struktura organizative dhe funksionet:

1. Njësi për shqyrtimin e përfomancës së Prokurorive, përbëhet nga këto zyre:
 - a) Zyra për statistika;
 - b) Zyra për mbikëqyrje, analitikë dhe verifikim prokurorial; dhe
 - c) Zyra për trajnime.

Neni 5

Zyra për statistika

1. Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorit, Menaxheri i Zyrës për Statistika është përgjegjës për mbarëvajtjen e punëve të zyrës dhe personelit, përfshirë por pa u kufizuar në këto autorizime dhe përgjegjësi:
 - a) Së bashku me Zyrën për mbikëqyrje dhe analitike zbaton politikat e KPK-së lidhur me metodologjitë, për përgatitjen e raporteve statistikore sipas kërkesës së KPK-së dhe komisioneve të saja.
 - b) Mbledh (grumbullon) informata dhe shënime statistikore në lidhje me punën e prokurorive dhe prokurorëve;
 - c) Themelon dhe mirëmban bazën e të dhënave për punën e prokurorëve dhe prokurorive;
 - d) Përpunon të dhëna dhe informata, përpilon raporte statistikore dhe raporte tjera;
 - e) Përpunon dhe sistemon të dhënat për secilën Prokurori dhe Prokuror veç e veç deri në nivel shteti;
 - f) Përgatitë raporte tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore statistikore të punës së Prokurorive;
 - g) Monitoron dhe mbikëqyrë funksionalizimin e bazave të dhënave, të themeluara nga KPK.
 - h) Trajnon stafin e prokurorive lidhur me funksionimin e bazës së të dhënave;
 - i) Gjeneron të dhëna statistikore dhe ofron mbështetje tjetër sipas kërkesave të Këshillit dhe komisioneve të KPK-së.

Neni 6

Zyra për mbikëqyrje, analitikë dhe verifikim prokurorial

1. Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorit, Menaxheri i Zyrës për Mbikëqyrje, Analitikë dhe verifikim prokurorial është përgjegjës për mbarëvajtjen e punëve të zyrës dhe personelit, përfshirë por pa u kufizuar në këto autorizime dhe përgjegjësi:
 - a) Sipas kërkesës së KPK-se, Komisionit për Vlerësim të Prokurorëve dhe planit vjetor të punës së Njësitit, bën mbikëqyrjen e:
 - i. Regjistrimit të rasteve, nëpër prokurori në pajtim me rregulloren për organizimin e brendshëm të Prokurorive;
 - ii. Arkivimin e dosjeve dhe lëndëve të mbyllura;
 - iii. mirëmbajtjen e plotë dhe të saktë të dosjeve të prokurorisë.
 - b) Kryen detyra dhe obligime të përcaktuara me rregulloret, vendimet dhe planet e punës së KPK-se, në aspektin e mbikëqyrjes.
 - c) Sipas kërkesës së KPK-se, Komisionit për Vlerësim të Prokurorëve dhe planit vjetor të punës së Njësitit të miratuar në KPK-së ofron mbështetje dhe i kryen të gjitha obligimet që dalin nga Rregullorja për Vlerësimin e Performances së Prokurorive.
 - d) Në bazë të raporteve statistikore të pranuar nga zyra për statistika, përpilon raporte përshkruese tre mujore, gjashtëmujore dhe vjetore lidhur me punën e Prokurorive.
 - e) Në bazë të raporteve statistikore të pranuar nga zyra për statistika, përpilon raporte analitike lidhur me shkallën dhe llojet e kriminalitetit në Kosovë.
 - f) Në bashkëpunim me zyrën për statistika përgatishin raportin vjetor statistikor dhe përshkrues lidhur me punën e prokurorive.
 - g) Në bashkëpunim me zyrën për statistika përgatishin raport të veçantë statistikor dhe përshkrues lidhur me veprat penale karakteristike të përcaktuara me mekanizmin përcjellës mbi unifikimin dhe harmonizimin e raporteve statistikore me agjencitë që zbatojnë ligjin në fushën e krimit të organizuar, korrupsionit, trafikimit me qenie njerëzore, trafikimit me arme,

trafikimit me narkotike, shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, dhe sekuestrimit dhe konfiskimit.

- h) Analizon të dhënat statistikore dhe informatat në lidhje me efikasitetin e punës së prokurorive.
- i) Përgatit raporte dhe i ofron mbështetje Komisionit për emërimin dhe ri-emërimin e prokuroreve.
- j) Sipas kërkesës së KPK-së, Komisioneve për Procesin e Emërimit dhe Ri-emërimit të Prokuroreve kryen edhe detyrat e përcaktuara me Rregulloren për procesin e rekrutimit, emërimit dhe ri-emërimit të prokuroreve, Rregulloren për vlerësimin e performancës së prokurorive, Vendimeve dhe akteve tjera nënligjore të miratuara në KPK.
- k) Shërben si sekretari i Komisionit për Emërim dhe ri-emërim të prokurorëve.

Neni 7 Zyra për Trajnime

1. Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorit, Menaxheri i Zyrës për Trajnime është përgjegjës për mbarëvajtjen e punëve të zyrës dhe personelit, përfshirë por pa u kufizuar në këto autorizime dhe përgjegjësi:
 - a) Koordinimin ,mbikëqyrjen dhe realizimin e planit të Trajnimeve për Prokurorët, zyrtarët e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe stafin mbështetës nëpër Prokurori.
 - b) Bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me partneret vendore dhe ndërkombëtare për të u siguruar prokurorëve dhe stafit tjetër të Këshillit Prokurorial trajnime adekuate.
 - c) Përgatitë raport me shkrim për KPK lidhur me pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnime.
 - d) Zyra i propozon KPK-se koordinimin e trajnimeve me IGJK sipas ligjit për Themelimin e institutit Gjyqësor.

- e) Përmes Këshillit Prokurorial të Kosovës, i propozon Institutit Gjyqësor të Kosovës plan programin vjetor për trajnime dhe seminare për prokurorët, varësisht nga nevojat.
- f) Përgatit raporte periodike dhe raporte sipas kërkesës së Këshillit për llojet e trajnimeve të ndjekura nga prokurorët dhe stafi tjetër si dhe raporte të trajnimeve të nevojshme.
- g) Në bashkëpunim me kryeprokurorin e shtetit dhe në koordinim me institucionet përkatëse për trajnime, është përgjegjëse për organizimin e trajnimeve dhe forma tjera, si debate, tryeza, konferenca.
- h) Zyra për trajnime bën koordinimin e të gjitha kërkesave përkitazi me pjesëmarrjen e Prokurorëve në trajnime.
- i) Zyra për trajnime do të sigurohet se pjesëmarrja e prokurorëve të të gjitha niveleve në trajnime, seminare, konferenca, tryeza apo takime të organizuara nga institucione vendore dhe ndërkombëtare apo organizata të ndryshme, do të realizohet vetëm pas miratimit nga Kryeprokurori i Shtetit dhe Kryeprokurori i Prokurorisë kompetente.
- j) Zyra për trajnime sigurohet që kërkesat për pjesëmarrje në trajnime, seminare, konferenca, tryeza apo takime të pranohen se paku tri dite pune para mbajtjes së tyre.
- k) Zyra për trajnime do të pranojë nga çdo pjesëmarrës në trajnim raportin përshkrues deri në dy faqe për trajnimin e ndjekur, i cili raport do të publikohet në ueb faqen e Këshillit.
- l) Kryen detyra të tjera sipas praktikave të miratuara nga KPK kryeprokurori i shtetit dhe drejtori i Njësitit.

Neni 8
Mbrojtja e të dhënave personale

Njësiti gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të tij do të ndërmerr të gjitha veprimet e parapara me ligj për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 9
Buxheti

1. Njësiti ka një buxhet të ndarë brenda buxhetit të konsoliduar të Këshillit dhe i raporton Këshillit në mënyrë të pavarur mbi shpenzimet e veta.
2. Njësiti planifikon buxhetin për aktivitetet e Njësitit dhe i propozon Këshillit Prokurorial propozim buxhetin për çdo vit kalendarik.

Neni 10
Ndryshimi dhe Plotësimi i Rregullores

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregulloreje bëhet në mënyrën dhe procedurën e njëjtë me të cilën është nxjerr.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Miratuar me datë 18 / 10 / 2013

Kryetari i Këshillit Prokurorial të Kosovës



Ismet Kabashi